




ANALIZA E CILËSISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE FUSHËN E PROCEDURËS KUNDËRVAJTËSE



**ANALIZA
E CILËSISË
SË VENDIMEVE
GJYQËSORE NË FUSHËN
E PROCEDURËS
KUNDËRVAJTËSE**

ANALIZA E CILËSISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE NË FUSHËN E PROCEDURËS KUNDËRVAJTËSE

Titulli origjinal i publikimit:

АНАЛИЗА НА КВАЛИТЕТОТ НА СУДСКИТЕ ОДЛУКИ
ВО ОБЛАСТА НА ПРЕКРШОЧНАТА ПОСТАПКА

Botues:

Instituti për politikë evropiane - Shkup

Asociacioni për iniciativa zhvillimore - Zenit Shkup

Redaktor:

Prof. Dr. Jovan Ananiev

Autore:

Dr. Marijana Llonçar Vellkova

Lektor:

Dejan Vasilevski

Përkthim nga gjuha maqedone në gjuhën shqipe:

Ismet Bitiq

Disenji dhe shtypi:

Relativ

Shkup, Korrik 2021

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

347.95:35.076.7.077.2(497.7)(047.31)

LLOŇÇAR Vellkova, Marijana

Analiza e cilësisë së vendimeve gjyqësore në fushën e procedurës kundërvajtëse
[Elektronски извор] / [autore Marijana Llonçar Vellkova ; përkthim nga gjuha maqedone
në gjuhën shqipe Ismet Bitiq]. - Shkup :

Instituti për politikë evropiane : Zenit, 2021. - 30 стр. ; 30 см

Начин на пристапување (URL): <https://epi.org.mk/post/17422?lang=sq>. - Превод
на делото: Анализа на квалитетот на судските одлуки во областа на прекршочната
постапка. - Текст во PDF формат, содржи 30 стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис
на изворот на ден 20.09.2021

ISBN 978-608-4702-13-9 (Институт за европска политика)

ISBN 978-608-4758-15-0 (Зенит)

а) Прекршочни постапки -- Судски одлуки -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 54588421



Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Partneriteti Justicija – kthimi i besimit të qytetarëve", i financuar nga Bashkimi Evropian përmes Sektorit për financim qendror dhe lidhje të marrëveshjeve në Ministrinë e Financave në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Përbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe assesi nuk mund të konsiderohet se i përfaqëson qëndrimet dhe pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	6
1. ANALIZA E CILËSISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE NË FUSHËN E PROCEDURËS KUNDËRVAJTËSE	7
1.1. KARAKTERISTIKAT E SHEMBULLIT PËR ANALIZË	8
1.2. ANALIZA E CILËSISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE NË NIVELIN E ZONAVE TË APELIT	10
1.2.1. CILËSIA E VENDIMEVE GJYQËSORE NË ZONËN E APELIT - MANASTIR	11
1.2.2. CILËSIA E VENDIMEVE GJYQËSORE NË ZONËN E APELIT - GOSTIVAR	14
1.2.3. CILËSIA E VENDIMEVE GJYQËSORE NË ZONËN E APELIT - SHKUP	17
1.2.4. CILËSIA E VENDIMEVE GJYQËSORE NË ZONËN E APELIT - SHTIP	22
2. ANALIZA E CILËSISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE NË NIVELIN KOMBËTAR	25
3. KONKLUZIONE TË PËGJITHSHME	27
4. REKOMANDIME	29

PARATHËNIE

Kjo analizë është bërë brenda projektit "Partneriteti Justicia: Kthimi i besimit të qytetarëve", që e zbatojnë Instituti për politikë evropiane dhe Asociacioni ZENIT, financuar nga Bashkimi Evropian. Projekti synon të kontribuojë për kthimin e besimit të qytetarëve në sektorin e drejtësisë maqedonase përmes përfshirjes së rëndësishme të shoqërisë civile në reformat thelbësore. Përfituesit përfundimtarë të këtij projekti janë institucionet në fushën e drejtësisë. Qëllimi i kësaj analize është të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore në fushën e të drejtës për kundërvajtje, të vetë procedurës me qëllim që t'iu përgjigjet pritjeve të qytetarëve në lidhje me të drejtën për një gjykim fer dhe të drejtë si dhe për qasje në drejtësi.

1.

**ANALIZA E CILËSISË
SË VENDIMEVE GJYQËSORE
NË FUSHËN E PROCEDURËS
KUNDËRVAJTËSE**

1.1. KARAKTERISTIKAT E SHEMBULLIT PËR ANALIZË

Me analizën e cilësisë së vendimeve gjyqësore u përfshin vendimet e miratuara në nivelin e katër zonave të Apelit të cilat përcaktohen me ligj sipas selisë së Gjykatave të Apelit, kurse janë krijuar për zonën e më shumë gjykatave të shkallës së parë (gjykatat themelore). Në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ekzistojnë katër Gjykata të Apelit me seli në Manastir, Gostivar, Shkup dhe Stip. Gjatë procedurës së mbledhjes së vendimeve që janë objekt i analizës, u morën parasysh disa parakushte: vendimet të miratohen në periudhën e viteve 2017, 2018, 2019 dhe 2020, të anonimizohen dhe në procedurat një nga palët të jetë një person fizik. Për atë arsye, janë përzgjedhur vendimet gjyqësore të miratuara në procedurat gjyqësore për kundërvajtje në fushat e rendit dhe qetësisë publike dhe trafikut.

Vendimet në procedurat e kundërvajtjes janë marrë pas adresimit me shkrim në gjykatat ose janë shkarkuar nga platforma dejure.mk. Gjatë mbledhjes së vendimeve nga gjykatat themelore dhe të apelit, kishte shumë vështirësi për të marrë një numër më të madh vendimesh të miratuara nga gjykatat, me siguri për shkak të numrit shumë të kufizuar të vendimeve anonime, ose fare nuk ka vendime të tilla në platformat zyrtare të gjykatave.

Në këtë analizë janë përfshirë gjithsej 60 vendime nga katër zonat e apelit, edhe atë si vijon: 14 vendime nga Zona e Apelit - Manastir (7 vendime të miratuara nga gjykatat themelore dhe 7 vendime të Gjykatës së Apelit - Manastir); 14 vendime nga Zona e Apelit - Gostivar (6 vendime të miratuara nga gjykatat themelore dhe 8 vendime nga Gjykata e Apelit - Gostivar); 23 vendime nga Zona e Apelit - Shkup (11 nga Gjykata Themelore Penale Shkup dhe 12 vendime nga Gjykata e Apelit); 9 vendime nga Zona e Apelit - Shtip (4 vendime nga Gjykatat Themelore dhe 5 vendime nga Gjykata e Apelit - Shtip).

Analiza është bërë vetëm në bazë të treguesve cilësorë konform Metodologjisë për analizën e cilësisë dhe uniformitetit të vendimeve gjyqësore dhe e njëjta nuk përmban kuantifikimin e rezultateve të fituara në bazë të treguesve kuantitativë konform metodologjisë. Secili prej vendimeve u analizua veçmas pa i krahasuar me njëri-tjetrin, duke zbatuar treguesit nga Metodologjia e përmendur.

Hulumtimi nuk i përfshin veprimet e organeve të administratës shtetërore, organizatave ose organeve të tjera që ushtrojnë autorizime publike të mbikëqyrjes mbi zbatimin e ligjeve me çka janë përshkruar kundërvajtjet, megjithëse në mënyrë indirekte përmes procedurave të tilla parandalohet shkelja e të drejtës të shumë personave fizik nga kundërvajtja e kryer nga personi juridik. Përndryshe, në Ligjin për Kundërvajtje¹ (LK) neni 49, përcaktohet se “një procedurë për kundërvajtje mund të zhvillojë dhe një sanksion për kundërvajtje mund të shqiptojë vetëm një gjykatë kompetente, kurse për kundërvajtje për të cilat është përcaktuar një gjobë më së shumti deri në 250 euro në kundërvlerë në denarë për një person fizik, 500 euro në kundërvlerë në denarë për një person përgjegjës në një person juridik dhe një zyrtar dhe 1.000 euro në kundërvlerë në denarë për personat juridikë, një procedurë për kundërvajtje mund të zhvillojë dhe një sanksion për kundërvajtje mund të shqiptojë një organ për kundërvajtje dhe një zyrtar i autorizuar”.

Në të vërtetë, qytetarët ose organizatat përkatëse që i përfaqësojnë interesat e tyre mund të paraqesin një njoftim para organeve kompetente të shtetit, inspektorateve (për shembull: Agjencia për komunikime elektronike, Agjencia për ushqim dhe veterinar, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale) dhe organe të tjera rregullatore, të cilat pastaj pas njoftimit të tyre, iniciojnë një procedurë. Në raste të tilla dhe të ngjashme, konform ligjit të veçantë material, sipas të cilit ky organ / institucion ose trup rregullator vendos, parandalohet dhe / ose sanksionohet sjellja e paligjshme e personit juridik dhe shqiptohet një sanksion përkatës për kundërvajtje, me çka mbrohen interesat e qytetarëve.

Në këtë hulumtim nuk janë marrë parasysh vendimet e Gjykatës Administrative, e cila ka kompetenca për të vendosur mbi të drejtat dhe detyrimet në çështjet individuale administrative, **si dhe për aktet e miratuara në një procedurë kundërvajtëse**, kur për zgjidhje në shkallën e dytë kundër një akti të tillë nuk është siguruar një mbrojtje tjetër juridike.

Fushat e listuara që nuk janë marrë parasysh në të ardhmen duhet të jenë lëndë e një analize më voluminoze e cila do të përfshijë fushën e të drejtës për kundërvajtje në të gjitha segmentet e saj.

¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.96/2019 më 17.05.2019

1.2 ANALIZA E CILËSISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE NË NIVELIN E ZONAVE TË APELIT

Treguesit në bazë të të cilëve është bërë një analizë cilësore e vendimeve gjyqësore të gjykatave themelore dhe të apelit janë listuar më poshtë:

- Struktura e vendimit gjyqësor;
- Shqiptimi;
- Koherenca;
- Sillogizmi ligjor gjatë subsumacionit;
- Arsyetimi i historisë së çështjes;
- Prezantimi i lëndës / çështjes;
- Situata faktike dhe procedura e provave;
- Shqyrtimi dhe vlerësimi i argumenteve të kundërta;
- Qartësia dhe qëndrueshmëria e arsyetimit;
- Saktësia gjuhësore dhe gramatikore e tekstit të vendimit gjyqësor;
- Udhëzime të qarta për gjykatën themelore gjatë kthimit të vendimit për rishqyrtim;
- Janë listuar në mënyrë të qartë arsyet për revokimin ose ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë;
- Nëse janë ndryshuar nga apeli volumi ose lartësia e sanksionit, kjo në arsyetimin është cekur në mënyrë të qartë pse është bërë ndryshimi, duke e theksuar ndryshimin në vlerësim me gjykatën themelore;
- Jepet një përgjigje në pretendimet ankimore;
- Nuk përshkruhet gjendja faktike nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë;
- Gjatë ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, vendimi gjyqësor i gjykatës së apelit i ka të gjitha karakteristikat në përcaktimin e gjendjes faktike, analizën e provave, citimin e të drejtës materiale dhe arsyetimin, sikurse edhe për çdo vendim të gjykatës së shkallës së parë. (në një rast të tillë, vlejnë rregullat për analizën e cilësisë së vendimit gjyqësor si dhe ato të vendimeve gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë - më sipër të listuara dhe përshkruhen në pjesën analiza cilësore);
- Vendimet e gjykatës së apelit, me të cilat refuzohet ankimi, kanë një arsyetim vetëm për ato pretendime ankimore, të cilat paraprakisht nuk janë deklaruar dhe për të cilat nuk ka përgjigje në vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e apelit i kushton vëmendje afatit për vjetërsimin absolut të çështjes kur duhet të vendos gjykata e shkallës së parë.

1.2.1. CILËSIA E VENDIMEVE GJYQËSORE NË ZONËN E APELIT - MANASTIR

Është bërë një analizë e gjithsej 14 vendimeve, nga të cilat 7 vendime të miratuara nga gjykatat themelore dhe 7 vendime nga Gjykata e Apelit - Manastir.

Në aspektin e **strukturës** së vendimit gjyqësor për këtë zonë të apelit, mund të konkludohet se të gjitha aktgjykimet e analizuara veç e veç i përmbajnë pjesët e nevojshme dhe të njëjtat janë strukturuar në mënyrë të drejtë. Për sa i përket **shqiptimit**, mund të konkludohet se shumica e vendimeve janë të qarta dhe koncize. Për sa i përket **koherencës së shqiptimit** të vendimeve (nëse e njëjta është në përputhje me arsyetimin) mund të përcaktohet se shumica e vendimeve janë në përputhje logjike me arsyetimin dhe nuk bien ndesh me vetveten.

Megjithatë, ekziston një devijim dhe vërehet se *disa vendime miratohen pa arsyetime, domethënë vetëm numrohen sanksionet e shqiptuara pa u zbatuar neni 113 paragrafi 7 i Ligjit për kundërvajtje të vitit 2019, ku në një mënyrë taksative dhe kumulative specifikohet në cilat raste miratohen vendime pa arsyetim: "aktgjykimi i miratuar në procedurë të shkurtuar, si dhe aktgjykimi me të cilin e pranon kundërvajtjen dhe kur heq dorë nga e drejta e ankimit nuk ka arsyetim."*

Për sa i përket shqiptimit në një nga vendimet vërehet se nuk përmbahen elementet themelore (koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, është përcaktuar vetëm rruga pa e treguar qytetin ku është kryer kundërvajtja), dhe në të njëjtën kohë në vetë vendimin nuk është deklaruar pse i njëjti vendim nuk përmban një arsyetim. Ekziston vetëm Shqiptimi i vendimit në të cilin është përshkruar kundërvajtja e kryer dhe sanksionet e shqiptuara për kundërvajtje, kurse nuk ka kurrfarë pretendime të tjera për miratimin e vendimit. Vendimi nuk ka arsyetim, por vetëm shqiptohen sanksionet, pa u zbatuar neni 113 paragrafi 7 i Ligjit për kundërvajtje nga viti 2019, ku në mënyrë taksative dhe kumulative është specifikuar në cilat raste miratohen vendime pa arsyetime.

Në aktgjykimet e tjera vërehet se në përmbajtjen e shqiptimit merret parasysh pohimi faktik i palëve përmes procedurës për të argumentuar se ku përcaktohet gjendja e fakteve të rëndësishme që veçohen nga ato të diskutueshme.

Në një vendim tjetër vërehet një devijim nga **sillogizmi ligjor** gjatë subsumacionit ku nuk janë respektuar ligjshmëria në miratimin e vendimit, domethënë vërehet se është shqiptuar një sanksion kundërvajtës, kurse në arsyetimin e vendimit thuhet se ka filluar procedimi penal i cili është ndaluar me një vendim për shkak të pajtimit ndërmjet të akuzuarit dhe palës së dëmtuar. **Si rregull, gjykata është dashtë të kishte ndaluar procedurën e kundërvajtjes duke u udhëhequr nga rregulli: "jo dy herë për të njëjtën"**.

Në një nga vendimet, u shqiptua sanksioni kundërvajtës - vërejtje (në përputhje me nenin 35 të Ligjit për kundërvajtje të vitit 2019). Gjykata me lexim i ka paraqit provat e tjera, duke konstatuar se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen, kurse gjatë vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, gjykata e ka vlerësuar gjendjen materiale, se i pandehuri nuk ishte i ndëshkuar, nuk janë krijuar pasoja të dëmshme për një person të tretë, por nuk ka konstatuar nëse i pandehuri është penduar për kundërvajtjen e kryer, që është një nga faktorët e rëndësishëm që në mënyrë edukative të ndikohet dhe të arrihen qëllimet e ndëshkimit.

Për sa i përket **cilësisë së arsytimit** të aktvendimit gjyqësor Ratio Decidendi, duhet të deklarojmë se në procedurën e kundërvajtjes vendimet janë të shkurtra, prandaj edhe arsytimi nuk përmban argumentim në lidhje me pohimet dhe aspektet vendimtare dhe kryesore. Arsyetimi zakonisht shkruhet në rreshta shumë të shkurtër sepse provat e paraqitura janë në një numër të vogël. Në shumicën e aktgjykimeve mungon kundërshtimi i argumenteve, kurse për sa i përket qartësisë dhe qëndrueshmërisë së vetë arsytimit, vërejtja është se i njëjti është pjesërisht i paqartë, sepse janë kopjuar procesverbalet gjatë dëgjimit të palëve. Gjithashtu, mungojnë dëshmitë e dëshmitarëve, si dhe dëgjimi i personave ekspertë.

Në aspektin e **saktësisë gjuhësore dhe gramatikore** të tekstit të vendimit gjyqësor, ato janë të kuptueshme për kryerësit e kundërvajtjeve, përmbajnë fjali të shkurtra dhe të qarta.

Në lidhje me **vendimet e Gjykatës së Apelit - Manastir**, vendimet përmbajnë udhëzime të qarta për gjykatën themelore, gjatë kthimit të vendimit për rishqyrtim, në mënyrë të qartë janë cekur arsyet e revokimit ose ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me ç'rast në arsyetimin, nëse ndryshon vëllimi ose lartësia e sanksionit, është cituar në mënyrë të qartë pse është bërë ndryshimi, duke specifikuar dallimin në vlerësimin me gjykatën themelore.

Po ashtu, jepet përgjigje në pretendimet ankimore, nuk përshkruhet gjendja faktike nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, mbahet llogari që të arsyetohen vetëm pretendimet ankimore që paraprakisht nuk janë deklaruar dhe në të cilat nuk ka përgjigje në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke i kushtuar vëmendje edhe afatit për vjetërsimin absolut.

Megjithatë ka disa devijime, për shembull: *vërehet se ka kaluar një periudhë e gjatë kohore nga kundërvajtja e kryer deri në vendimin përfundimtar, si për shembull në një nga aktgjykimet ku konstatohet se: "Të pandehurit lirohen nga përgjegjësia për shkak të vjetërsisë së ndjekjes për kundërvajtje", por shtrohet pyetja pse për një kundërvajtje të kryer në vitin 2012 është miratuar një vendim nga Gjykata Themelore - Ohër në vitin 2018, kurse Gjykata e Apelit - Manastir në lidhje me këtë lëndë vendos në vitin 2019, kështu që procedura zgjat 6 vjet".*

Në një vendim tjetër, Gjykata konstaton se është kryer një shkelje e ligjit material, por e njëjta shkelje konsiderohet se është në favor të të pandehurit dhe kjo është arsyeja pse nuk e bënë ndryshimin e vendimin, por të njëjtin vetëm e konstaton, gjë që e bën të paqartë vendimin në këtë pjesë. Në vendimin e tretë, duke konkluduar se bëhet fjalë për një aksident trafiku, Gjykata e Apelit përcakton se parashikohet detyrimisht lëshimi i një urdhërpagese të detyrueshme që nuk është lëshuar, gjë që është në kundërshtim me dispozitat e ligjit ku thuhet se: "në rast të një aksidenti trafiku, procedura zhvillohet para gjykatës dhe ajo shqipton një sanksion për kundërvajtje - gjobë dhe ndalimi i drejtimit me mjetin", kështu që bëhet e paqartë pse gjykata e ka pranuar ankesën e paraqitësit dhe ka shqiptuar një sanksion kundërvajtës pa i marrë parasysh rrethanat se kur mund të shqiptohet një vërejtje.

KONKLUZION

Aktgjykimet e analizuara veç e veç i përmbajnë pjesët e nevojshme dhe të njëjtat janë strukturuar në mënyrë të drejtë. Shumica e vendimeve janë të qarta dhe koncize, merret parasysh edhe pohimi faktik i palëve përmes procedurës për dëshmim ku përcaktohet gjendja e fakteve të rëndësishme që dallojnë nga ato të diskutueshme. Për sa i përket koherencës së shqiptimit të vendimeve, ekziston një harmoni logjike me arsyetimin dhe të njëjtit nuk bien ndesh me vetveten.

Ekziston një devijim në vendime të caktuara, veçanërisht kur aktgjykimi miratohet pa arsyetim, pa u zbatuar neni 113 paragrafi 7 i Ligjit për Kundërvajtje të vitit 2019, ku në mënyrë taksative dhe kumulative specifikohet se në cilat raste miratohen vendime pa arsyetime.

Në vendimet e Gjykatës së Apelit - Manastir përmbahen udhëzime të qarta për gjykatën themelore, përcaktohen në mënyrë të qartë arsyet për revokimin ose ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, nëse ndryshon volume ose lartësia e sanksionit, është specifikuar në mënyrë të qartë pse është bërë ndryshimi, duke sugjeruar dallimin në vlerësimin me gjykatën themelore. Po ashtu, jepet përgjigje në pretendimet ankimore, nuk përshkruhet gjendja faktike nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, mbahet llogari për të arsyetuar vetëm pretendimet ankimore që parapakisht nuk janë deklaruar dhe në të cilat nuk ka përgjigje në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke i kushtuar vëmendje afatit për vjetërsimin absolut. Megjithatë, ka disa devijime të caktuara që nuk reflektohen rëndësishëm në cilësinë e vendimeve gjyqësore.

1.2.2. CILËSIA E VENDIMEVE GJYQËSORE NË ZONËN E APELIT -GOSTIVAR

Është bërë një analizë e gjithsej **14** vendimeve, nga të cilit **6** vendime të miratuara nga gjykatat themelore të Zonës së Apelit - Gostivar, dhe **8** vendime të Gjykatës së Apelit - Gostivar.

Në lidhje me **strukturën** e vendimit gjyqësor për këtë zonë të apelit, mund të konkludohet se aktgjykimet e analizuara veç e veç në një pjesë nuk i përmbajnë pjesët e nevojshme dhe të njëjtit pjesërisht janë strukturuar në mënyrë të drejtë.

Në lidhje me **shqiptimin**, mund të konkludohet se pjesa më e madhe e vendimeve janë të qarta dhe koncize.

Në lidhje me **koherencën e shqiptimit** të vendimeve (nëse i njëjti është në përputhje me arsyetimin) mund të përcaktohet se në shumicën e vendimeve mungon arsyetimi, prandaj nuk mund të konkludohet se të njëjtit nuk bien ndesh me vetveten.

Vërehen devijime për faktin se shumica e vendimeve të analizuara miratohen pa arsyetime, domethënë, vetëm numrohen sanksionet e shqiptuara, pa e zbatuar nenin 113 paragrafi 7 i Ligjit për kundërvajtje: „Vendimi i miratuar në një procedurë të shkurtuar, si dhe vendimi me të cilin i pandehuri e pranon kundërvajtjen dhe kur heq dorë nga e drejta e ankimit, nuk ka arsyetim“. Në këtë ligj në mënyrë taksative dhe kumulative është specifikuar në cilat raste miratohen vendime pa arsyetime, domethënë një vendim i tillë miratohet nëse i pandehuri e ka pranuar kundërvajtjen, e ka kompensuar dëmin dhe ka heq dorë nga e drejta e ankimit, kurse një konstatim i tillë nuk ka në deklaratën e të pandehurit, kurse në një pjesë të vendimeve nuk janë paraqitur as palët, kështu që një vendim i tillë miratohet në mungesë.

Në lidhje me shqiptimin në një nga vendimet vërehet se *”shuma e sanksionit kundërvajtës është përcaktuar sipas kursit të blerjes së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kurse duhet të jetë në bazë të kursit të mesëm të BPRMV-së”*. Në pjesën e logjikës juridike, në pjesën më të madhe nuk lejohet që të futemi në vlersim për arsye se në shumicën e aktgjykimeve të analizuara nuk ka pohim faktik të palëve dhe një procedurë për dëshmim.

Në një vendim tjetër vërehet një devijim nga **sillogizmi ligjor** gjatë subsumacionit, ku ligjshmëritë logjike nuk respektohen gjatë miratimit të vendimit. Në aktgjykimet e tjera vërehet se në përmbajtjen e arsyetimit merret parasysh edhe pohimi faktik i palëve përmes procedurës për dëshmim ku përcaktohet gjendja e fakteve të rëndësishme që janë të veçuara nga ato të diskutueshme.

Për sa i përket **cilësisë së arsyetimit** të aktvendimit gjyqësor Ratio Decidendi, duhet të deklarojmë se në procedurën e kundërvajtjes vendimet janë të shkurtra, prandaj edhe arsyetimi nuk përmban argumentim në lidhje me pohimet dhe aspektet vendimtare dhe kryesore.

Arsyetimi zakonisht është shkruar në rreshta shumë të shkurtër pa i specifikuar në mënyrë përkatëse provat që vlerësohen (duke e specifikuar numrin e tyre dhe datën) madje edhe nëse provat e paraqitura kanë vërtetim përkatës, kurse provat që paraqiten janë në një numër të vogël.

Në shumicën e aktgjykimeve mungon kundërshtimi i argumenteve, kurse për sa i përket qartësisë dhe qëndrueshmërisë së vetë arsyetimit, vërejtja është se i njëjti është pjesërisht i paqartë, sepse janë kopjuar procesverbalet gjatë dëgjimit të palëve. Gjithashtu, mungojnë dëshmitë e dëshmitarëve, si dhe dëgjimi i personave të kualifikuar.

Sa i përket **saktësisë gjuhësore dhe gramatikore** të tekstit të vendimit gjyqësor, të njëjtit në një pjesë janë të pakuptueshme për autorët e kundërvajtjeve, nuk janë formuluar në mënyrë të qartë dhe përmbajnë gabime gramatikore.

Për sa i përket vendimeve të Gjykatës së Apelit - Gostivar, në vendimet në mënyrë të qartë janë specifikuar arsyet për ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, *por në një nga vendimet në arsyetimin gjatë ndryshimit të volumit ose lartësisë së sanksionit nuk përcaktohet në mënyrë të qartë pse është bërë ndryshimi, duke e specifikuar dallimin në vlerësimin me gjykatën themelore.*

Po ashtu, jepet përgjigje në pretendimet ankimore, nuk përshkruhet gjendja faktike nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, mbahet llogari që të arsyetohen vetëm pretendimet ankimore që paraprakisht nuk janë deklaruar dhe për të cilat nuk ka përgjigje në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke i kushtuar vëmendje afatit për vjetërsimin absolut.

Megjithatë, vërehet një devijim në zbatimin e së drejtës materiale që nuk kryhet në përputhje me normat juridike pozitive, *domethënë në një vendim zbatohet e drejta materiale pa specifikuar se cilat janë rrethanat që çojnë deri në zbutjen e sanksioneve kundërvajtëse, që i bën vendimet të jenë të paqartë dhe të pakuptueshëm.*

Në vendime të tjera, gjithashtu, vërehen devijime:

- Një nga vendimet është voluminoz dhe i paqartë, në të vërtet gjykata themelore ka shqiptuar një sanksion për kundërvajtje me gjobë prej 50 eurosh, duke u bazuar në nenin 33 paragrafi 5 cc me nenin 390 të Ligji për sigurinë e trafikut rrugor - LSTRR (bëhet fjalë për një aksident trafiku). Në përputhje me nenin 390 paragrafi 1 alinea 1) parashikohet shqiptimi - ndalimi i drejtimit me mjetin nga 30 ditë deri në 3 muaj kur parashikohet një gjobë në vlerë prej 50 euro;
- Në një vendim tjetër, Gjykata e Apelit citon një dispozitë ku thuhet se gjoba është 45 euro në përputhje me nenin 390 paragrafi 1 i LSTRR-së (Ligji për Sigurinë e Trafikut Rrugor), kurse në ligjin në atë nen shkruan - një gjobë e përcaktuar prej 50 euro dhe jo një gjobë prej 45 euro;

- Në vendimin e tretë në rastin e një sanksioni me rritje të dyfishtë, i njëjti mund të dyfishohet dhe duhet të arrijë në 100 euro, e jo 90 euro. Ndalimi i drejtimi me mjetin është shqiptuar për një periudhë prej 30 ditësh, kurse duhet të jetë minimum 3 muaj (parashikohet një sanksion prej 3-6 muajsh);
- Në vendimin e katërt ekziston një tregues se i njëjti është kontradiktor në vetvete, sepse gjykata e apelit konsideron se gjykata themelore me vendimin e shqiptuar i ka tejkaluar kompetencat me atë që në lidhje me gjobën e kërcënuar prej 300 euro kanë bërë zbutje dhe ka shqiptuar një sanksion kundërvajtës - gjobë prej 200 euro, duke e cituar ligjin ku konform nenit 31 të LK (2015) thotë se gjoba mund të zbutet më së shumti për 1/3. Konkludohet se gjykata themelore ka mund ta zbutë dhe e ka zbutur shumë e gjobës në përputhje me Ligjin për kundërvajtje të vitit 2015. Mbetet e paqartë pse Gjykata e Apelit i referohet Ligjit për Kundërvajtje të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë 51/2011, kurse i citon nenet e LK-së të vitit 2015.

KONKLUZION

Në pjesën më të madhe të vendimeve ka një zbatim të gabuar të drejtës materiale në lidhje me nenin 113 paragrafi (7), domethënë një vendim i cili miratohet në një procedurë të shkurtuar dhe që nuk ka arsyetim mund të miratohet nëse konform nenit 113 paragrafi (7), i pandehuri tërhiqet nga ankimi (në këtë rast vendimi është miratuar në mungesë, domethënë i pandehuri nuk e ka tërhequr ankesën). Në pjesën më të madhe të vendimeve të analizuara, nuk zbatohet në mënyrë të drejtë e drejta materiale, bëhen shkelje thelbësore të procedurës kundërvajtëse, veçanërisht në pjesën e vendimeve që nuk përmbajnë arsyetime.

Nga vendimet e analizuara të Gjykatës së Apelit për pjesën më të madhe konkludohet se kanë mangësi që pjesërisht nuk janë thelbësore, ndërsa pjesërisht janë zbatuar gabimisht rregulloret ligjore pozitive.

1.2.3. CILËSIA E VENDIMEVE GJYQËSORE NË ZONËN E APELIT - SHKUP

Në qasjen e analizës janë bërë përpjekje për të marrë vendime gjyqësore anonime nga Gjykata Themelore Penale - Shkup, mirëpo fillimisht u lejua vetëm kontrollimi i vendimeve në hapësirat e gjykatës, pa ia dorëzuar kërkesit. Arsyetimi se në portalin e gjykatës nuk ka vendime anonime për shkak të volumit të madh të punës nuk është shumë e pranueshme për publikun profesionist. Më vonë, përmes ridrejtimit dhe bisedave, përmes postës elektronike na u dërguan vendimet që iu përgjigjën kërkesave tona. Është bërë një analizë e gjithsej **23 vendimeve nga Zona e Apelit - Shkup**, nga të cilat 11 nga Gjykata Themelore Penale - Shkup dhe 12 nga Gjykata e Apelit - Shkup.

Në aspektin e **strukturës** së vendimit gjyqësor për këtë zonë të apelit, mund të konkludohet se të gjitha aktgjykimet e analizuara veç e veç i përmbajnë pjesët e nevojshme dhe të njëjtat janë strukturuar në mënyrë të drejtë. Sa i përket **shqiptimit**, mund të konkludohet se shumica e vendimeve janë të qarta dhe koncize. Në lidhje me **koherencën së shqiptimit** të vendimeve (nëse e njëjta është në përputhje me arsyetimin) mund të përcaktohet se shumica e vendimeve janë në përputhje logjike me arsyetimin dhe nuk bien ndesh me vetveten. Vërehet se në përmbajtjen e shqiptimit merret parasysh edhe pohimi faktik i palëve përmes procedurës për dëshmim ku përcaktohet gjendja e fakteve të rëndësishme që veçohen nga ato të diskutueshme. Në vendimet nuk vërehet ndonjë devijim nga **sillogizmi ligjor** gjatë subsumacionit ku janë respektuar ligshmëritë logjike gjatë vendimmarrjes.

Si një shembull mund të citohet një nga vendimet në rastin e një aksidenti trafiku, me ç'rast i pandehuri ka kryer dy kundërvajtje për çka i është shqiptuar një sanksion i vetëm - gjobë dhe ndalim i drejtimit të mjetin për tre muaj. Nga shuma e gjobës së sanksionit të shqiptuar për kundërvajtje në përputhje me ligjin varet edhe shuma e sanksionit të shqiptuar ndalim i drejtimit me mjetin për tre muaj. Në këtë rast është shqiptuar një sanksion kundërvajtës në një shumë prej 198 euro në kundërvlerë në denarë prej 12,180 denarë. I pandehuri nuk e ka pranuar kundërvajtjen e bërë, kurse gjykata e ka dëgjuar dëshmitarin okular dhe paraqitësin e akuzës për kundërvajtje me ç'rast i ka shqyrtuar dosjet dhe gjatë shqiptimit të sanksionit kundërvajtës i mori parasysh të gjitha rrethanat, por nuk e pranoi dhe nuk e besoi deklaratën e dhënë nga i pandehuri sepse ka konsideruar se është e paargumentuar dhe në kundërshtim me provat e paraqitura. Është zbatuar një procedurë kontradiktore, në të cilën janë paraqitur të gjitha provat e nevojshme mbi bazën e të cilave gjykata ka miratuar një vendim të drejtë.

Për sa i përket **cilësisë së arsyetimit** të aktvendimit gjyqësor Ratio Decidendi, i njëjti më së shpeshti është shkruar përmes një vlerësimi të provave që janë sjellë, edhe pse në procedurat e kundërvajtjes ato janë në një volum të vogël. Në shumicën e aktgjykimeve ka kundërshtime të argumenteve, kurse për sa i përket qartësisë dhe qëndrueshmërisë së vetë arsyetimit, vërejtja është se kjo në një pjesë të vendimeve është e paqartë, sepse

procesverbalet janë kopjuar gjatë dëgjimit të palëve. Por, megjithatë, disa nga vendimet përmbajnë dëshmi të dëshmitarëve me ç'rast është bërë një korrelacion i deklaratave të dhëna dhe arsyetimit të dhënë për atë se cilës deklaratë gjykata i ka dhënë ose nuk i ka dhënë besimin gjatë përgatitjes së vendimit.

- Në një vendim vërehet se gjyqtari gjatë veprimit në bazë të kërkesës së paraqitur zhvillon një seancë gojore, ndërsa në vetë vendimin plotësisht janë cituar deklaratat e të pandehurit dhe palës së dëmtuar, si dhe të dëshmitarit, që e bën vendimin voluminoz, kurse me këtë edhe i paqartë në pjesën e arsyetimit që është dhënë në 10 faqe. Dilema mbetet nëse një vendim për kundërvajtje duhet të përmbajë një arsyetim kaq gjithëpërfshirës, duke i cituar të gjitha deklaratat. Megjithatë, mund të konstatohet se dispozitat ligjore janë respektuar plotësisht.
- Një nga vendimet është marrë në mungesë të të pandehurit, mirëpo plotësisht janë zbatuar dispozitat ligjore në lidhje me personat fizikë, në këtë rast bëhet fjalë për sanksionin kundërvajtës - gjobë e shqiptuar në një shumë prej 250 euro (parashikuar në një shumë prej 15 deri në 250 euro). Është vepruar sipas rregulloreve pozitive ligjore. U shënua një gabim teknik në arsyetimin në pjesën ku thuhet se letra-kthyesë të datës 06.04.2020 është kthyer në gjykatë me shënimin "është njoftuar më 269.03.2020, nuk ka kërkuar", me ç'rast nuk mund të përcaktohet se në cilën ditë është njoftuar i pandehuri.
- Në një vendim tjetër, vërehet se vendimi është miratuar në mungesë të të pandehurit, duke llogaritur se i njëjti është thirrur në mënyrë të rregullt dhe nuk është paraqitur në gjykatë, madje as nuk e ka arsyetuar mungesën e tij, prandaj gjykata ka konsideruar se nga provat e bashkangjitura mund të marrë një vendim edhe pa e marrë në pyetje të pandehurin, duke e shqiptuar sanksionin maksimal të parashikuar për kundërvajtje - gjobën. Thirrja është vendosur në tabelën e shpalljeve të gjykatës, kurse gjykata nuk disponon me të dhëna për adresën e qëndrimit të të pandehurit në momentin kur thirrja është vendosur në tabelën e shpalljeve të gjykatës. Kjo e fundit është veçanërisht e rëndësishme për arsye se kundërvajtja është kryer më 15.12.2016, kurse kërkesa është dorëzuar më 10.01.2017, ndërsa deri në ditën e vendosjes në tabelën e shpalljeve të gjykatës (më 11.04.2019) kanë kaluar më shumë se dy vjet. Paraprakisht kontrollohet nëse i pandehuri jeton në atë adresë, kurse pastaj thirrja vendoset në tabelën e shpalljeve të gjykatës. Kur ftesa vendoset në tabelën e shpalljeve të gjykatës konform ligjit, duhet të përcaktohet edhe neni i ligjit që parashikon një procedurë të tillë për shpallje / për ftesë.
- Në vendimin e tretë në mungesë të të pandehurit i cili është thirrë në mënyrë të rregullt por nuk është paraqit në gjykatë dhe nuk e ka justifikuar mungesën e tij, është miratuar një sanksion kundërvajtës për drejtimin me mjetin. Në këtë rast, gjykata ka vlerësuar se ka prova të mjaftueshme për të miratuar një vendim pa e marrë në pyetje të pandehurin, duke i marrë parasysh dosjet, dhe veçanërisht

faktin se i pandehuri ka lëvizur me shpejtësi më të madhe sesa lejohet gjë që është matur me radar dhe është konstatuar në procesverbalin të cilin i pandehuri e ka nënshkruar me çka e ka pranuar kundërvajtjen e kryer. Gjykata, duke mbajtur llogari për dosjet në lidhje me këtë lëndë, ka miratuar një vendim në përputhje me ligjin në mungesë të të pandehurit, duke i vlerësuar të gjitha rrethanat e parashikuara sipas ligjit (lehtësuese dhe rënduese) dhe në mënyrë të drejtë e ka matur sanksionin e miratuar për kundërvajtje.

Në një nga vendimet për kundërvajtje shënohet se i pandehuri ka regjistruar pikë negative, kurse gjykata vepron vetëm në pjesën për shqiptimin e sanksionit kundërvajtës: ndalimi i drejtimit me mjetin. I pandehuri edhe pse i thirrur personalisht në mënyrë të rregullt nuk është paraqitur në gjykatë, kurse gjykata ka konsideruar se në bazë të dosjeve të bashkangjitura lëndës do të mund t'i shqiptojë një sanksion kundërvajtës - ndalimi i drejtimit me mjetin për tre muaj, duke marrë parasysh sasinë e përcaktuar të alkoolit në organizëm dhe faktin se i pandehuri paraprakisht nuk është dënuar për kundërvajtje.

Ngjashëm me vendimin e mëparshëm, në një vendim tjetër gjyqësor që është miratuar në prani të të pandehurit, gjykata i ka shqiptuar një sanksion kundërvajtës - ndalim i drejtimit me mjetin për 3 muaj duke marrë parasysh se sasia e alkoolit në organizëm është 0,55 promil, duke mbajtur llogari se i pandehuri është një njeri familjar dhe i punësuar, kurse automjeti i është i domosdoshëm për detyrimet e punës. Në të njëjtën kohë, gjykata mori parasysh që i pandehuri shprehu keqardhje dhe pendim për kundërvajtjen e kryer dhe se paraprakisht nuk është dënuar për kundërvajtje, dhe për këtë arsye e shqiptoi minimumin e sanksionit të parashikuar.

Sa i përket **saktësisë gjuhësore dhe gramatikore** të tekstit të vendimit gjyqësor, ato janë të kuptueshme për autorët e kundërvajtjeve, dhe përmbajnë fjali të qarta.

Në lidhje me vendimet e **Gjykatës së Apelit - Shkup**, vendimet përmbajnë udhëzime të qarta për gjykatën themelore, gjatë kthimit të vendimit për rishqyrtim, janë specifikuar në mënyrë të qartë arsyet e revokimit ose ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me ç'rast në arsyetimin - nëse ndryshon volumi ose lartësia e sanksionit në mënyrë të qartë është specifikuar pse është bërë ndryshimi, duke e theksuar dallimin në vlerësimin me gjykatën themelore. *Megjithatë, në një nga vendimet, i cili në thelb është i qartë dhe u referohet dispozitave ligjore, nuk përmendet / deklarohet nëse gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar edhe rrethanat lehtësuese gjatë zbutjes së sanksionit kundërvajtës - ndalimi i drejtimit me mjetin që të pandehurit i ka shqiptuar një sanksion kundërvajtës për drejtimin e mjetit prej 1 muaj në përputhje me nenin 29 të LK-së (nga 1 muaj deri në 12 muaj). Në këtë rast, Gjykata e Apelit shqipton një sanksion më të rreptë ndalimi për drejtimin e mjetit dhe këtë nuk e arsyeton.*

Gjithashtu, u jepet përgjigje pretendimeve ankimore, nuk kopjohet gjendja faktike nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, mbahet llogari që të arsyetohen vetëm pretendimet ankimore që paraprakisht nuk janë deklaruar dhe për të cilat nuk ka përgjigje në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke i kushtuar vëmendje edhe në bazë të obligimit zyrtarë të ndryshimeve ligjore dhe mospërputhjeve në vendimin - zbatimin e ligjit më të butë dhe afatit për vjetërsimin absolut. Vërehet se ka kaluar një periudhë e gjatë kohore nga kundërvajtja e kryer deri në marrjen e vendimit përfundimtar, si për shembull në një nga aktgjykimet ku konkludohet se për një kundërvajtje të kryer në vitin 2015, vendimi merret në vitin 2020.

Në një nga vendimet, megjithëse është një vendim i saktë dhe i qartë që u referohet dispozitave ligjore, nuk përmendet / citohet nëse gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe rrethanat lehtësuese gjatë zbutjes së sanksionit kundërvajtës - ndalimi i drejtimit me mjetin që të pandehurit i ka shqiptuar një sanksion kundërvajtës për drejtimin e mjetit prej 1 muaj në përputhje me nenin 29 të LK-së (nga 1 muaj deri në 12 muaj). Në këtë rast, Gjykata e Apelit shqipton një sanksion më të rreptë - ndalim i drejtimit me mjetin dhe të njëjtin nuk e arsyeton.

Në një vendim tjetër perceptohet se Gjykata e Apelit sqaron në mënyrë të saktë pse e pranon zbutjen e shqiptimit të sanksionit kundërvajtës - ndalim i drejtimit me mjetin për 1 muaj, duke deklaruar se mbështetet nga provat që janë në favor të të pandehurit, në përputhje me nenin 29 të LK-së (prej 1 muaj deri në 12 muaj). Megjithatë, krahasuar me një vendim tjetër, shtrohet pyetja se si në çështjen e mësipërme është konfirmuar vendimi i gjykatës themelore, kurse në rastin e fundit është rrit sanksioni kundërvajtës. Mbase që nuk disponojmë me vendimet e gjykatës themelore në lidhje me këto dy lëndë nuk mund të bëjmë një krahasim të plotë.

Në një nga vendimet, për një kundërvajtje të kryer në vitin 2015, vendimi është miratuar në vitin 2020, gjë që çon në një përfundim se procedura po zhvillohet 5 vjet dhe 4 muaj. Shtrohet pyetja se çfarë është efekti i një zhvillimi kaq të gjatë të procedurës kundërvajtëse nga fusha e kundërvajtjeve në lidhje me rendin dhe qetësinë publike dhe si i njëjti i godet kryerësit.

KONKLUZION

Vendimet në thelb janë konciz, të qartë dhe të kuptueshëm, me një përshkrim të mjaftueshëm të argumenteve të kundërta. Në të njëjtën kohë, citohen ligje dhe sqarime për arsyet për shkak të cilave janë pranuar ose jo pretendimet ankimore, duke mbajtur llogari për çdo segment të vendimit të gjykatës themelore dhe duke e vlerësuar në tërësi, e jo vetëm në pjesën që është ankimuar.

Janë respektuar ligjshmëritë logjike në miratimin e vendimeve në sasinë më të madhe. Arsyetimi te pjesa më e madhe e vendimeve më së shpeshti është shkruar përmes një vlerësimi të provave të cilat kryhen, edhe pse në procedurën kundërvajtëse të njëjtit janë në një sasi të vogël. Vendimet përmbajnë deklaratatë të dëshmitarëve me ç'rast është bërë një korrelacion i deklaratave të dhëna dhe një arsyetim i dhënë për atë se cilës deklaratë gjykata i ka kushtuar ose nuk i ka kushtuar besimin gjatë përgatitjes së vendimit. Në pjesën më të madhe të vendimeve ekziston kundërshtim i argumenteve, kurse në aspektin e qartësisë dhe konsistencës së vetë arsyetimit vërejtja është se i njëjti te një pjesë e vendimeve është i paqartë, sepse janë kopjuar procesverbalet gjatë dëgjimit të palëve. Vendimet janë të kuptueshme për autorët e kundërvajtjeve, gjegjësisht përmbajnë fjali të qarta.

Në vendimet e Gjykatës së Apelit - Shkup vërehet se vendimet përmbajnë udhëzime të qarta drejtuar gjykatës themelore, gjatë kthimit të vendimit për rishikim, në mënyrë të qartë janë specifikuar arsyet për heqjen ose ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me ç'rast në arsyetimin, nëse ndryshohet volumi ose lartësia e sanksionit, është deklaruar në mënyrë të qartë pse është bërë ndryshimi, duke treguar dallimin në vlerësimin me gjykatën themelore. Megjithatë, në një nga vendimet që në thelb është i qartë dhe u referohet dispozitave ligjore, nuk përmendet / citohet nëse gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar edhe rrethanat lehtësuese në zbutjen e sanksionit kundërvajtës, në një vendim tjetër ka kaluar një perudhë e madhe kohore e zhvillimit të procedurës, kurse në një vendim të tretë është shqiptuar një sanksion më i rreptë ndalimi i drejtimit me mjetin pa u dhënë një arsyetim.

1.2.4. CILËSIA E VENDIMEVE GJYQËSORE TË ZONËS SË APELIT - SHTIP

Është bërë një analizë e gjithsej 8 vendimeve, nga të cilat 4 vendime të miratuara nga gjykatat themelore të zonës së apelit Shtip dhe 4 vendime të Gjykatës së Apelit - Shtip.

Sa i përket **strukturës** së vendimit gjyqësor për këtë zonë të apelit, mund të konkludohet se të gjitha aktgjykimet e analizuara veç e veç i përmbajnë pjesët e nevojshme dhe të njëjtit janë strukturuar në mënyrë të drejtë.

Edhe pse në aspektin e **shqiptimit** mund të konkludohet se pjesa më e madhe e vendimeve janë të qarta dhe koncize, por megjithatë vërehen devijime të caktuara, si për shembull në një nga vendimet ku "është shqiptuar një gjobë prej 400 euro", gjegjësisht nuk është zbatuar ligji më i butë për kryerësin deri në 250 euro në përputhje me LK-në të vitit 2019. *Në një vendim tjetër, sanksioni për kundërvajtje është shqiptuar në kufijtë minimalë nën minimumin ligjor të përcaktuar, sepse i pandehuri është i papunë dhe në vend të gjobës së kërcënuar prej 350 deri në 400 euro, është shqiptuar në një shumë prej 100 euro. Arsyeja është papunësia e të pandehurit, por gjykata nuk e ka përcaktuar me një provë të drejtpërdrejtë dhe të njëjtit nuk i ka propozuar punë të dobishme të përgjithshme në përputhje me ligjin. Në të njëjtën kohë, në këtë rast, nuk janë shqyrtuar të gjitha rrethanat që do ta bënin kundërvajtjen më të lehtë.*

Sa i përket **koherencës së shqiptimit** të vendimeve (nëse i njëjti është në përputhje me arsyetimin) mund të përcaktohet se shumica e vendimeve janë në një harmoni logjike me arsyetimin dhe nuk janë në kundërshtim me vetëveten. Megjithatë, ekziston një devijim dhe vërehet se në përmbajtjen e shqiptimit merret parasysh edhe pohimi faktik i palëve përmes procedurës për dëshmim ku nuk përcaktohet gjendja e fakteve të rëndësishme që veçohen nga ato të diskutueshme.

- Në një vendim vërehet një devijim nga **sillogizmi ligjor** gjatë subsumacionit ku nuk janë respektuar ligjshmëritë logjike në miratimin e vendimit, në të vërtet, në një nga vendimet vërehet se është shqiptuar një gjobë prej 400 euro, nuk është zbatuar ligji më i butë për kryerësin deri në 250 euro në përputhje me LK-në të vitit 2019.
- Në një vendim tjetër, gjoba e shqiptuar nuk është në përputhje me nenin 26 paragrafi 1 të LK-së të vitit 2019 dhe me këtë nuk është zbatuar ligji më i butë për kryerësin edhe pse i referohet këtij ligji. Gjoba maksimale është prej 15 deri 250 euro, kurse është shqiptuar një gjobë prej 400 euro. Me këtë rast është dhënë një deklaratë e dëshmitarit, pa një konstatim se ku është marrë në pyetje dëshmitari dhe nëse e njëjta deklaratë është e ndërlidhur me provat e tjera të kryera. Nuk ka kontradiktë në procedurë.
- Në një vendim të tretë është shqiptuar një sanksion për kundërvajtje - vërejtje, me ç'rast nuk është marrë parasysh se vërejtje nuk mund të shqiptohet nëse kryerësi nuk e ka përmbushë detyrimin e përcaktuar, si dhe kur janë shkaktuar pasojat e dëmshme dhe është rrezikuar edhe interesi publik.

Sa i përket **cilësisë së arsytimit** të aktvendimit gjyqësor Ratio Decidendi, mund të konstatohet se arsytimi më së shpeshti është shkruar në rreshta shumë të shkurtër për arsye se provat e paraqitura janë në një numër shumë të vogël. Në shumicën e aktgjykimeve mungon kundërshtimi i argumenteve, kurse sa i përket qartësisë dhe qëndrueshmërisë së vetë arsytimit, vërejtja është se i njëjti është pjesërisht i paqartë, sepse janë kopjuar procesverbalet gjatë dëgjimit të palëve. Gjithashtu, mungojnë dëshmitë e dëshmitarëve.

Në aspektin e **saktësisë gjuhësore dhe gramatikore** të tekstit të vendimit gjyqësor, ato janë të kuptueshme për kryerësit e kundërvajtjeve, përmbajnë fjali të shkurtra dhe të qarta.

Në lidhje me **vendimet e Gjykatës së Apelit - Shtip**, vendimet përmbajnë udhëzime të qarta për gjykatën themelore, gjatë kthimit të vendimit për rishqyrtim, në mënyrë të qartë janë cekur arsyet e revokimit ose ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me ç'rast në arsytimin, nëse ndryshon volumi ose lartësia e sanksionit, është cituar në mënyrë të qartë pse është bërë ndryshimi, duke specifikuar dallimin në vlerësimin me gjykatën themelore. Po ashtu, jepet përgjigje në pretendimet ankimore, nuk përshkruhet gjendja faktike nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, mbahet llogari që të arsyetohen vetëm pretendimet ankimore që paraprakisht nuk janë deklaruar dhe në të cilat nuk ka përgjigje në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke i kushtuar vëmendje edhe afatit për vjetërsimin absolut.

Megjithatë, ka devijime të caktuara, si për shembull në një nga vendimet që është i paqartë dhe i pakuptueshëm, sepse në të njëjtin është cituar rprocesverbali për kryerjen e kontrollit të shpejtësisë së lëvizjes së mjetit dhe jo procesverbali për testimin e kryer për alkool. Kjo për shkak se kundërvajtja është kryer në përputhje me nenin 228, paragrafi 1, kurse i dënueshëm me nenin 228 paragrafi 7 i LSTRR-së, i pandehuri e ka drejtuar mjetin nën ndikimin e alkoolit dhe jo me një shpejtësi të palejueshme. Gjatë citimit të provave të paraqitura, është bërë një gabim: "është cituar procesverbali për kontrollin e kryer të shpejtësisë së lëvizjes së mjetit, por jo edhe procesverbali për testimin e kryer për alkool".

KONKLUZION

Nga të gjitha vendimet e analizuara, mund të konkludohet se në masë më të madhe, vendimet i përmbajnë pjesët e nevojshme dhe të njëjtit janë të strukturuar në mënyrë të drejtë, të miratuar në bazë të së drejtës materiale, kurse në përmbajtjen e shqiptimit merret parasysh edhe pohimi faktik i palëve përmes procedurës së dëshmimit. Megjithatë, ka edhe devijime kur, për shembull, nuk përcaktohet gjendja e fakteve të rëndësishme që veçohen nga ato të diskutueshme, kurse në një pjesë të vogël konstatohet se ka një zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ose, madje, nuk është mbajtur logari për kontradiktën e procedurës, kurse diku është shqiptuar gjobë me ç'rast nuk është sqaruar nëse i njëjti është zbutë ose jo.

Vendimet e Gjykatës së Apelit - Shtip janë të shkurtra dhe me më pak sqarime (për shembull, krahasuar me vendimet e Gjykatës së Apelit - Shkup), por megjithatë janë të kuptueshme, është mbajtur llogari për zbatimin e ligjeve, përveç në një vendim ku si provë specifikohet procesverbali për shpejtësinë e lëvizjes, kurse kundërvajtja e kryer është për drejtimin nën ndikimin e alkoolit, që është kontradiktor, i paqartë dhe i pakuptueshëm.

2.

ANALIZA E CILËSISË SË VENDIMEVE GJYQËSORE NË NIVELIN KOMBËTAR

Në analizën e vendimeve gjyqësore nga të katër zonat e apelit, është marrë parasysh vetëm një analizë cilësore. Kjo analizë i referohet strukturës, koherencës së shqiptimit, cilësisë së arsytimit, aspektit gjuhësor dhe gramatikor të vendimit gjyqësor, me ç'rast mund të konkludohet se në nivelin kombëtar nuk ka devijime të caktuara në lidhje me **strukturën** e vendimeve gjyqësore në nivelin e zonave të apelit.

Sa i përket **koherencës së shqiptimit** (nëse i njëjti është në përputhje me arsytimin) vërehet një devijim në disa vendime që miratohen pa arsytim, gjegjësisht vetëm listohen sanksionet e shqiptuara, pa u zbatuar neni 113 paragrafi 7 i Ligjit për kundërvajtje të vitit 2019, ku në mënyrë taksative dhe kumulative specifikohet se në cilat raste miratohen vendime pa arsytim (**një vendim pa arsytim miratohet nëse i pandehuri e ka pranuar kundërvajtjen, e ka kompensuar dëmin dhe ka hek dorë nga e drejta e ankimit**).

*Gjithashtu, në disa nga vendimet ka devijime në lidhje me **sillogjizmin ligjor** gjatë subsumacionit ku nuk respektohen ligjshmëritë logjike.*

Sa i përket **cilësisë së arsytimit** të vendimit gjyqësor Raporti Decidendi, edhe pse në procedurën kundërvajtëse vendimet janë të shkurtra dhe arsytimi më së shpeshti shkruhet në rreshta shumë të shkurtër për arsye se provat që paraqiten janë në një numër të vogël, megjithatë nuk ekziston njëtrajtshmëri gjatë përgatitjes së arsytimit. Në disa vendime ndodh të kopjohen procesverbalet gjatë seancës dëgjimore të palëve dhe mungojnë dëshmitë e dëshmitarëve, si dhe dëgjimi i ekspertëve.

Kur bëhet fjalë për **saktësinë gjuhësore dhe gramatikore** të tekstit të vendimit gjyqësor, mund të themi se në nivelin kombëtar nuk ka devijime të mëdha, ato janë të kuptueshme për kryerësit e kundërvajtjeve, me përjashtime të caktuara.

Gjykatat e apelit tregojnë njëtrajtshmëri më të madhe kur bëhet fjalë për vendimet gjyqësore, veçanërisht Gjykata e Apelit - Manastir dhe Gjykata e Apelit - Shkup. Shumica e vendimeve përmbajnë udhëzime të qarta për gjykatën themelore, gjatë kthimit të vendimit për rishqyrtim dhe në mënyrë të qartë janë specifikuar arsyet e revokimit ose ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me ç'rast në arsytimin, nëse ndryshon volumi ose lartësia e sanksionit, në mënyrë të qartë është specifikuar pse është bërë ndryshimi, duke e specifikuar dallimin në vlerësimin me gjykatën themelore. Gjithashtu, në shumicën e rasteve, u jepet përgjigje pretendimeve ankimore, nuk përshkruhet gjendja faktike nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, mbahet llogari që të arsyetohen vetëm pretendimet ankimore të cilat paraprakisht nuk janë deklaruar dhe për të cilat nuk ka përgjigje në vendimin e shkallës së parë gjyqësore, duke i kushtuar vëmendje edhe afatit për vjetërsimin absolut.

Përjashtime të caktuara nga këto rregulla janë dhënë në tekstin e analizës, që janë vërejtur për secilën zonë të apelit.



3.

**KONKLUZIONE
TË PËGJITHSHME**

- Mund të shihet se ka një uniformitet më të madh të vendimeve të miratuara brenda Zonave të Apelit Shkup dhe Manastir.
- Ekziston nevoja për një uniformitet më të madh në vendimet gjyqësore në zonat e apelit në Gostivar dhe Shtip.
- Vërehet se në një pjesë të vendimeve paraqitet vjetërsimi i ndjekjes kundërvajtëse.
- Në raste të caktuara të aksidenteve në trafik, nuk lëshohet një urdhër-pagesë i detyrueshëm, kundërvajtës, i cili duhet të paguhet brenda 8 ditëve në përputhje me ligjin, me çka të pandehurit i shqiptohen kosto më të larta se sa është e nevojshme në procedurën e kundërvajtjes.
- Vërehet se në raste të caktuara vendimi miratohet në procedurë të shkurtuar dhe pa arsyetime, në mungesë të të pandehurit, gjegjësisht, pa mbajtur llogari në cilat raste mund që të mos hartohet arsyetimi në procedurën e shkurtuar, megjithëse në ligj në mënyrë taksative janë përcaktuar rastet në të cilat gjykata mund të marrë një vendim pa arsyetime. Në lidhje me vendimet e tilla, konstatohet zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.
- Kur bëhet fjalë për zbutjen e sanksionit kundërvajtës - gjobë, nuk arsyetohen arsyet e zbutjes së bërë të gjobës dhe nuk specifikohet baza mbi të cilën është shqiptuar gjoba (nuk specifikohen nenet e LK-së).
- Ekziston një dallim në sanksionet kundërvajtëse - gjobat, kur gjykata i referohet ligjit ku gjobat janë të ndryshme nga ato në të cilat referohet gjykata përmes një dispozite, kurse ekzistojnë raste kur sanksioni kundërvajtës që duhet të dyfishohet do të duhet të shqiptohet në vendimin gjyqësor në një shumë tjetër sesa që është përcaktuar.
- Ekziston një dallim në shqiptimin e sanksionit kundërvajtës - ndalimi i drejtimit me mjetin, gjegjësisht, shqiptohet një sanksion më i butë (p.sh. shqiptohet për një kohëzgjatje prej 30 ditësh, kurse duhet të jetë minimum 3 muaj).
- Në një pjesë të vendimeve konstatohet shqiptimi i një sanksioni më të rreptë ndalimi i drejtimit me mjetin pa u arsyetuar.
- Shtrohet pyetja për volumin e arsytimit, gjegjësisht nevojës të bëhet duke i cituar të gjitha deklaratat, gjë që e bën atë shumë voluminoz dhe të vështirë për tu lexuar, me ç'rast vendimi nuk është mjaft i qartë dhe konciz.
- Në një pjesë të vendimeve paraqiten gabime teknike dhe gjuhësore në arsytimin.
- Nuk është e mundur të bëhet një vlerësim në lidhje me çështjet juridike, për të cilat praktika gjyqësore maqedonase, gjegjësisht Gjykata Supreme ka miratuar pozicione parimore juridike, mendime parimore juridike, mendime juridike, konkluzione dhe vendime ose konkluzione të mbledhjeve të gjykatave të apelit në procedurën e kundërvajtjes mbasi që nuk kishte mundësi të sigurohen. Gjithsesi, paraqet sfidë nevoja për një bashkëpunim më të madh ndërmjet institucioneve në mënyrë që të harmonizohen pikëpamjet dhe mendimet, veçanërisht për zbatimin e ligjeve në praktikë, kurse nga hulumtimi rezultoi se është e nevojshme të miratohen qëndrime dhe mendime juridike për miratimin e vendimeve në procedurë të shkurtuar dhe pa arsyetime.



4.

REKOMANDIME



- Me qëllim që të arrihet një përkushtim dhe vëmendje më e madhe gjatë përgatitjes së vendimeve, është e nevojshme të punohet në harmonizimin e praktikës gjyqësore, veçanërisht përmes programeve të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë me zbatimin e edukimit të synuar për harmonizimin e vendimeve për sa i përket strukturës së tyre, zbatimit të së drejtës dhe zhvillimit të procedurës kundërvajtëse;
- Nevojitet një monitorim më i madh i vendimeve të gjykatave nga organet kompetente të të gjitha zonave të apelit, duke bërë analiza krahasuese vjetore, duke marrë parasysh të gjitha kriteret e cilësisë dhe të vlerësimit të dhëna në Metodologjinë për analizën e cilësisë dhe uniformitetit të vendimeve gjyqësore;
- Gjithashtu, nevojitet të organizohen takime për shkëmbimin e përvojës dhe praktikës, si dhe përgatitjen e udhëzimeve (drejtimeve) për çështje të caktuara juridike;
- Në të ardhmen do të duhet që Gjykata Supreme të miratojë qëndrime parimore juridike, mendime parimore juridike, mendime juridike dhe konkluzione dhe vendime ose përfundime të takimeve të gjykatave të apelit për çështje të caktuara në procedurën e kundërvajtjes me qëllim që të vendoset një praktikë unike dhe të avancohet procedura kundërvajtëse.

